



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 3073/1 Prot.

Përmet, më 24.09.2025

Përgjigje ndaj kërkesës suaj, datë 10.09.2025, protokolluar pranë Bashkisë Përmet me nr.3073 prot, datë 22.09.2025

Në vijim të pyetjeve të parashtruara nga subjekti juaj, ju informojmë si më poshtë:

1. Hidrocentralet e ndërtuara në territorin e Bashkisë Përmet në periudhën janar 2010 – gusht 2025

Aktualisht ushtrojnë aktivitet 5 (pesë) hidrocentrale, të cilat janë:

- Ish Komuna Frashër – Shoqëria Hidro Energia Pulita shpk me Administrator z. Besnik Halili, zotëron 3 hidrocentrale.
- Ish Komuna Petran – Shoqëria Lengarica Energy & Energy me Administrator z. Ylli Halili.
- Ish Komuna Çarçovë – Shoqëria Erma MP shpk me Administrator z. Maksim Fejzulla.

Këto hidrocentrale janë ndërtuar kryesisht në sipërfaqe pyjore dhe kullosore, jashtë fondit pyjor dhe kullosor që administrohet nga Bashkia Përmet, por që janë nën administrimin e AKZM-së. Lejet për ushtrimin e aktivitetit janë dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Statusi i funksionimit

Të 5 (pesë) hidrocentralet e mësipërme janë aktualisht në funksion.

3. Hidrocentrale jashtë funksionit

Në territorin e Bashkisë Përmet nuk ka hidrocentrale jashtë funksionit.

4. Projekte të reja

Deri në momentin e dhënies së këtij informacioni, nuk ka projekte të reja për ndërtimin e hidrocentraleve në territorin e Bashkisë Përmet.

5. Lumenjtë dhe degët ku janë ndërtuar HEC-et

Hidrocentralet janë ndërtuar kryesisht në degë të lumenjve të Vjosës, përkatësisht në territorin e ish-komunave Frashër, Petran dhe Çarçovë.

6. Studimet e ndikimit mjedisor

Për secilin prej këtyre hidrocentraleve është kryer procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ato janë depozituar pranë institucioneve përgjegjëse shtetërore (MIE dhe AKZM). Bashkia Përmet nuk zotëron kopje të tyre për t'i vënë në dispozicion.

7. Përfitimet ekonomike për Bashkinë Përmet

Hidrocentralet nuk gjenerojnë të ardhura direkte për Bashkinë Përmet, pasi taksat dhe detyrimet paguhen pranë organeve qendrore tatimore dhe jo pranë bashkisë. Nga ana e punësimit lokal, numri i të punësuarve rezidentë në Bashkinë Përmet është i kufizuar dhe nuk ka të dhëna të detajuara mbi këtë tregue

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 3072/11 Prot

Datë 30/09/2025.

Lënda: Kthim përgjigje.

Në përgjigje të kërkesës Tuaj datë: 19/09/2025 protokolluar me tonën me nr 3072 prot datë 22.09.2025 , me objekt: "Kërkesë për informacion" të kërkuara sipas pikave si më poshtë:

1. Cilat janë vëndodhjet zyrtare të depozitimit të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë suaj? A janë këto vëndepozitime sanitare? Nese po kur janë krijuar? Nëse jo, përse nuk janë marë masa për përmirësimin e tyre.

- Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara aktualisht depozitohet në vënd-depozitim të mbetjeve, e cila ndodhet rreth 12 km nga qendra e qytetit Përmët, në krahun e majtë të rrugës Piskove-Pagri rreth 3 km nga rruga nacionale Përmët- Këlcyrë. Ky vënd-depozitim i përkohëshëm është një investim i realizuar nga Ministria e Mjedisit dhe vënë në funksion në Korrik të vitit 2022, duke bërë të mundur mbylljen e vënd-depozitimit të mëparshëm në vëndin e quajtur „Brackove“ i cili ndodhej rreth 3 km nga qyteti i Përmetit.

2. Sa është sasia e mbetjeve urbane qe gjeneron bashkia juaj? Sa është fondi vjetor në dispozicion për pastrimin që ka në dispozicion bashkia juaj? Cili është burimi i financimit? Sa është taksë e pastrimit dhe sa të ardhura mblidhni nga kjo taksë? Ku i depozitoni mbetjet dhe sa janë kostot e transportit? Të dhënat të jënë për 5 vitet e fundit.

- Sasia e mbetjeve urbane që gjeneron bashkia është mesatarisht 8 ton/ditë. Sasia e mbetjeve urbane e depozituar në vëndepozitim të Piskovës për vitin 2025 deri në muajin Gusht është 1 850 ton.
- Burimi i financimit për menaxhimin e mbetjeve urbane, transfertat specifike e pakushtëzuar, të ërdhurat e grumbulluara nga tarifa e pastrimit, donatorë të ndryshëm.
- Tabela e të adhurave e shpenzimeve për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmët:

TE ARDHURA, MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE

Bashkia Permet	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Plan	fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	9,120	6,638	12,950	11,213	13,200	14,803	13,220	14,331	13,000	12,296

SHPENZIME, MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE

Bashkia Permet	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Plan	fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	17,845	17,577	17,950	17,950	40,300	37,782	36,675	27,124	57,507	16,317

- Taksa e pastrimit për familjarët është 2 400 lek/vit, kurse për bizneset është në varësi të aktivitetit të biznesit dhe zonës së operimit. Konkretisht qyteti Përmet nga 7 800 lek/vit – 113 000 lek/vit. Për subjekte karburante dhe institucione me aktivitet të madh deri në 170 000 lek/vit.
- Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara depozitohet në vënd-depozitim të mbetjeve, e cila ndodhet rreth 12 km nga qendra e qytetit Përmet

3. A ka Bashkia juaj plan konkret për mbylljen e vendepozitimeve josanitare të mbetjeve dhe për rehabilitimin e zonave të ndotura.

- Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve, si dhe në kuadër të Planit Rajonal për menaxhimin e mbetjeve në ZMM Gjirokastrë – Vlora Jug, si pjesë e projektit EU4RËM të inicjuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kontributin e BE dhe Agjensisë Franceze për Zhvillim (AFD) pjesë e së cilës është edhe Bashkia e Përmetit, është parashkuar ndërtimi i një Stacioni Transferimi (ST) për dy Bashkitë (Përmet-Këlcyrë). Si pjesë e Projektit Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta financuar nga BE-ja në Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve Gjirokastrë dhe Vlorë Jug, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) është tashmë në procesin e përcaktimit të vlefshmërisë së vendeve të përzgjedhura për infrastrukturen rajonale dhe të Sistemit Rajonal të Mbetjeve. Aktualisht është bërë vlerësimi paraprak dhe propozimi për vendndodhjen e vendeve që do të konsiderohen për të ndërtuar Stacionet Transferimi (ST) të propozuara, dhe potencialisht infrastruktura shtesë sic mund të jenë Qendrat për Mbetjeve Voluminoze - Ishuj Ekologjik, (termi në anglisht Civic Amenity Centers). Kryerja e vëzhgimeve paraprake teknike, mjedisore dhe sociale (për të identifikuar nëse ka ndonjë rrezik teknik, mjedisor ose social të lidhur me vendndodhjen e vendit të propozuar. Këshilli i Bashkisë Përmet me Vendimin nr 5 datë 30.01.2025 ka miratuar në parim vendosjen dhe operimin e stacionit të transferimit (ST) të mbetjeve në funksion të zones së menaxhimit të mbetjeve Gjirokastrë – Vlora Jug për Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë. Vendi i propozuar nga Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese, ndodhet jashtë territorit të Bashkisë Përmet, në kufi me territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe ndodhet me koordinata (40°17'32.57"N - 20°14'25.53"E). Destinacioni final i mbetjeve urbane mbas vënies në funksion të ST do të jetë lanfill i "Bajkajt" Delvinë.

4. Cilat janë projektet për përmirësimin e kësaj situatë?

Sheshi "Abdyi Frashëri"; tel. +35581322254; web: www.bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

- Në kuadër të projektit EU4RËM të inicjuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kontributin e BE dhe Agjensise Franceze për Zhvillim (AFD) pjesë e së cilës është edhe Bashkia e Përmetit, është parashkuar ndërtimi i një Stacioni Transferimi (ST) për dy Bashkitë (Përmet-Këlcyrë) Destinacioni final i mbetjeve urbane mbas vënies në funksion të ST do të jetë lanfill i "Bajkajt" Delvinë. Ndërtimi dhe vënia në funksion e ST, nga projekti parashikon mbylljen e vënd-depozitimit aktual në "Piskovë", si dhe atij të mëparshëm në "Brackovë".
- Nëpërmjet bashkëpunimit me GIS jemi duke realizuar një projekt për ndarjen në burim të mbetjeve (si fillim kartonin-plastikën) duke vendosur në fillim në qytetin e Përmetit disa "kosha" të dedikuar, si dhe më pas presimin e tyre në një vënd të ndërtuar për këtë qëllim dhe më pas destinacionin final të tyre, tregun privat apo kompanive të interesuara.
- Gjithashtu nëpërmjet GIS jemi duke realizuar një projekt për ndarjen në burim të mbetjeve (si fillim kartonin-plastikën) duke vendosur në fillim në qytetin e Përmetit disa "kosha" të dedikuar, si dhe më pas presimin e tyre në një vënd të ndërtuar për këtë qëllim dhe më pas destinacionin final të tyre, tregun privat apo kompanive të interesuara.

Ne e vlerësojmë shumë kontributin **Tuaj** në ndërgjegjësimin qytetar, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve urbane, pasi për ne mbetet një sfidë e madhe të cilën me angazhimin maksimal të strukturave tona, mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, kontributin e donatorëve të ndryshëm, do të bëjmë të mundur të kemi një qytet dhe territor sa më të pastër, si një zonë me tradita kulturore, mikëpritje, kulinarie, me një rritje të turizmit cdo vit e më shumë.

Duke ju falenderuar.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi

NËNKRYETARI

Florand HASANI

